

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË "UNICERT " SH.P.K)

Sot, më datë 20.02.2024, u hartua dhe neshkrua kjo kontratë për shitje kuotash kapitali ndërmjet paleve si më poshtë:

SHITES:

Vjola Canka, atësia Fatos, amësia Elida, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në TIRANË, me adresë Besim Imami; Nd. 66; H. 4; Ap. 31; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 16/08/1990, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Letërnjoftim ID nr. 033839869 dhe nr. personal J05816059A.

BLERES:

Tereza Matraku, atësia Luan, amësia Federata, shtetase Shqiptare, lindur në Korçë dhe banuese në TIRANË, me adresë Muhamet Deliu 03900085; Nd. 26; H. 13; Ap. 22; Dajt; Linzë; 1040; Tiranë, lindur më 21/01/1987, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Letërnjoftim ID nr. 036856851 dhe nr. personal I75121084O.

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë për shitjen të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "UNICERT" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

1. OBJEKTI

1.1 Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi **Vjola Canka**, i shet palës blerëse, shtetases **Tereza Matraku 1 (një)** Kuotë që përbëjnë **100 %** (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të regjistruar të **Shoqërisë "UNICERT" sh.p.k** person juridik privat i së drejtës shqiptare, identifikuar me Nr. NIPT (NIUS) M21628036N dhe seli në adresën: Tiranë, Njësia Administrative nr.7, Rruga Nikolla Jorga, Ndertesë 1, Apartamenti 42, zk. 8250, nr pasurie 5/309+1-35..

2. ÇMIMI

2.1 Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së kuotave të kapitalit të Shoqërisë, të jetë në vlerën totale prej 10.000 (dhjetë mijë) lekësh.

2.2 Palët deklarojnë se në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate, çmimi i shitjes së kuotave është likuiduar nga Blerësi. Palët, Shitësi dhe Blerësi nuk kanë asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm për çmimin e shitjes sipas kësaj Kontrate. Kalimi i pronësive nga shitësi tek blerësi do të jete menjehere me nënshkrimin e kësaj kontrate.

3. MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

3.1 Pronësia mbi 100 % të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë "UNICERT" sh.p.k, do të kalojë nga pala shitëse, **Vjola Canka**, tek pala blerëse **Tereza Matraku** në momentin e depozitimit të kësaj Kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, Tiranë.

3.2 Nga momenti i depozitimit të Kontratës në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pala shitëse, **Vjola Canka** humbet çdo të drejtë pronësie mbi **100%** të kapitalit të zotëruar në Shoqëri, dhe këto të drejta fitohen nga blerësi **Tereza Matraku**, e cila nga ky moment bëhet pronare e Shoqërisë "UNICERT" sh.p.k", me strukturën e pjesëve si vijon:

Ortakët e Shoqërisë	Pjesët e Zotëruara	Përqindja e Kapitalit	Vlera në lek[
---------------------	--------------------	-----------------------	---------------



TEREZA MATRAKU	1	100%	10.000
Totali	1 kuotë	100%	10.000

4.1 Pala shitëse detyrohet:

- T'i kalojë palës blerëse pronësinë mbi kuotat objekt i kësaj kontrate të lirë nga çdo barrë, sekuestrim dhe detyrime të çfarëdolloj natyre.
- T'i dorëzojë palës blerëse dokumentacionin mbi pronësisë e kuotave që i shet nëpërmjet kësaj kontrate.
- Të paguajë shpenzimet e regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

5. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

5.1 Për këtë Kontratë, do të jenë bazë për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë,
- Legjislacioni që rregullon organizimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare;
- Aktet e tjera ligjore që nuk bien në kundërshtim me këtë kontratë.

5.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të shfaqen midis palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhjen apo vlefshmërinë e kësaj Kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim mes tyre, në rast të kundërt organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. DISPOZITA TË FUNDIT

6.1 Kontrata u përpilua në 5 (pesë) kopje me fuqi të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe, nga një kopje ju jepet palëve, një kopje depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), dhe një kopje duhet të depozitohet në selinë e Shoqërisë.

6.2 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht.

6.4 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", palet deklarojne se do të ruajnë dhe përpunojnë të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES

Vjola Canka

BLERES

Tereza Matraku